



Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute

www.kdi-kosova.org

(Mos) Deklarimi i pasurisë (Non) Disclosure of Assets

Prishtinë, Gusht / August 2010

This publication was made possible through support provided by U.S. Agency for International Development Mission in Kosovo under the terms of Award Number: 167-A-00-00108-00-NAP05-2009.

The opinions expressed herein are those of the author and do not necessarily reflect the views of the U.S. Agency for International Development (USAID).

Ky publikim është realizuar me mbështetje të siguruar nga Agjencioni i SHBA-s për Misionin Ndërkombëtar për Zhvillim në Kosovë nën kushtet e Numrit të grantit: 167-A-00-00108-00-NAP05-2009.

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorit dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

PERSONELI:

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*
Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*
Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*
Arsim GJINOVCI - *IT & design*

PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:

Valmir ISMAILI - *Menaxher programi*
Driton SELMANAJ - *Asistent i programit*
Isuf ZEJNA - *Monitorues*
Besnik RAMADANAJ - *Monitorues*
Liridon SELMANI - *Monitorues*

PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - *Koordinator*
Ramadan KLISURICA - *Koordinator*

PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*
Esat MAZREKU - *Koordinator*

Përmbajtja

Hyrje	6
Metodologjia	7
Të gjeturat.....	7
Vlerësim mbi rastet që nuk e kanë deklaruar pasurinë.....	8
Mosdeklarimi dhe mospublikimi i formularëve me rastin e marrjes ose lënies së postit.....	9
Gjobat.....	9
Deklarimi në mënyrë jo të rregullt.....	10
Mangësitë.....	10
Kreditë.....	11
Deklarimet e rregullta.....	12
Pambulushmëria e aseteve të përfituara me pagën.....	13
Mosdeklarimi i prejardhjes.....	13
Dy problemet themelore.....	14
Stafi.....	14
Legjislacioni i mangët.....	15
Përfundim.....	16

Analizë mbi zbatimin e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik

Realizimi i kësaj analize është mundësuar nga USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë civile implementuar nga Instituti për Komunitete të Qendrueshme në kuadër të projektit "Bazë Ligjore dhe Mekanizma Funkcional për një Qeverisje të Mirë". Ky projekt synon "të ndikoj në ndërtimin dhe fuqizimin e principeve të një shoqërie demokratike ku sundon ligji; për një qeverisje të përgjegjshme, transparente dhe në shërbim të qytetarëve".

1. HYRJE

Në vitin 2007, Agjencia Kundër Korrupsionit (tani e tutje vetëm AKK) ka hartuar formularin i cili do të përdorej për të dokumentuar pasurinë e zyrtarëve të lartë, prejardhjen dhe kontrollin e saj. Baza ligjore ka qenë ligji kundër korrupsionit. Që nga ajo kohë, AKK ka kaluar nëpër një periudhë evoluimi, dhe aprovimi i Ligjit për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik i ka mundësuar AKK-së që ti publikoj formularët e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve në faqen e internetit, gjë që ndodhi për herë të parë në Qershor të vitit 2010.

Publikimi i Formularëve bëri një lajm të rëndësishëm në media dhe në jetën politike në përgjithësi. Por, a është në të vërtetë deklarimi i fundit pasurisë shenjë e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e zyrtarëve të lartë, apo e kundërta? Kjo është pyetja së cilës kjo analizë do të përpiqet ti japë përgjigje. Kjo do të bëhet përmes analizimit të rasteve të zyrtarëve të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë, duke e vënë theksin në reagimin (ose mos reagimin) nga ana e Agjencionit Kundër Korrupsionit. Do të analizohen gjambat dhe dhe qëndrimi i agjencisë në lidhje me këto raste.

Më tutje, kjo analizë do të trajtojë edhe formularët të cilët kanë probleme serioze përse i përket mënyrës së plotësimit dhe pasurisë së deklaruar. Do të trajtohen edhe mangësitë të cilat më së shpeshti hasen në rastet kur plotësohen formularët.

Edhe pse janë hasur shumë pak raste ku është vërejtur një qasje më korrekte ndaj formularit, kjo analizë prezanton ato dhe ofron shembuj se si në të vërtetë do të duhej plotësuar formularët.

Gjatë procesit të analizës është vërejtur se në formularët e disa prej zyrtarëve deklarohet pasuri e përfituar shumë më e madhe nga ajo që dikush do të mund të grumbullonte me pagën që këta zyrtarë marrin nga pozitat që kanë. Me sa duket, zyrtarët nuk brengosen për këtë fakt, por ne do të përpiqemi ti analizojmë edhe shkaqet pse ata e bëjnë një gjë të tillë, dhe se a ka mundësi që ata të hetohen për këtë. Roli i AKK-së është i pakontestueshëm në këtë rast, prandaj vëmendje do ti kushtohet edhe pozicionit të këtij institucioni në të gjithë procesin e deklarimit, prejardhjes dhe kontrollit të pasurisë.

Është mbase hera e parë që një analizë e tillë i është bërë procesit të deklarimit të pasurisë nga zyrtarët e lartë. Prandaj, një studim dhe debat më i gjërë i kësaj teme është i domosdoshëm, nëse dëshirohet që ky proces të jetë i suksesshëm dhe t'i arrijë objektivat e synuara në luftë kundër korrupsionit.

Kjo analizë synon të ofroj informacion rreth asaj se sa është duke u respektuar ligji mbi deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik. Analiza njëkohësisht ka për objektive të arsyetoj mbi atë se pse nuk duhet pritur që nga formularët e publikuar të vihet në përfundimin nëse zyrtarët e lartë publik kanë abuzuar me pozitat e tyre gjat periudhës sa ata kanë ushtruar funksione publike.

II. METODOLOGJIA

Rastet që do të trajtohen në raport do të jenë kampionët më përfaqësues te grupi të deklaruesve të klasifikuar si të rregullt, të parregullt, dhe të atyre të cilët nuk mund ta arsyetojnë prejardhjen e pasurisë. Këto raste do të interpretohen mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi, dhe do të tentohet të kuptohet se ku kanë ndodhur shkeljet dhe cilat janë masat ndëshkimore.

Qështja më sfiduese mbeti analizimi i të dhënave të mbledhura për t'i përdorur si një informacion me integritet, me qëllim të vlerësimit dhe kontrollit të aseteve të zyrtarëve tanë. Vështirësia në analizimin e këtyre të dhënave është e qartë, pasi që nuk ka informacione mbështetëse (nga AKK dhe prokuroria ose gjykatat), përmes të cilave do të arrihet të bëhen krahasime. Kjo do të mund të arrihej vetëm nëse premtimi i AKK-së për të instaluar një data-bazë në vitin e ardhshëm bëhet realitet. Zyrtarët e këtij institucioni synojnë që me këtë sistem të ri të evidentimit të të dhënave do të mundësohet një analizë dhe krahasim shumë më i avancuar i formulave dhe kontrollimit të pasurisë së zyrtarëve në të ardhmen¹.

Qëllimi i kësaj analize nuk është emërtimi i të gjithë atyre që nuk e kanë plotësuar formularin në mënyrë të rregullt, por evidentimi i shkeljeve të cilat hasen më së shpeshti dhe prezantimi i tyre përmes rasteve tipike që përdoren si kampionë.

III. TË GJETURAT²

1. 68 zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë në kohë;
2. Ndëshkimet për ta do të jenë vetëm masat kundërvajtëse administrative;
3. Shumica e formularëve janë të plotësuar në mënyrë të parregullt;
4. Deklarimi i prejardhjes së pasurisë nuk mund të garantohet;
5. Zyrtarët për të cilët provohet se e kanë deklaruar rrejshëm pasurinë, nuk ndiqen penalisht;
6. Legjislacioni në fuqi ka karakter preventiv dhe jo sanksionues;
7. AKK nuk ka resurse të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për ta implementuar ligjin;
8. Formularët janë të dizajnuar dobët dhe janë të papërshtatshëm;

¹ Intervistë e autorit me Jetullah Aliun, Drejtor i Departamenteve në AKK. 26. 07. 2010.

² Për të parë një formular të deklarimit të pasurisë dhe mënyrën e plotësimit, të bërë nga një zyrtar i lartë publik në Sh.B.A., shko tek:

http://www.washingtonpost.com/wp-srv/politics/congress/fin_dis/2006/b000444.pdf

IV. VLERËSIM MBI RASTET QË NUK E KANË DEKLARUAR PASURINË

Në bazë të të dhënave të ofruara nga AKK, kuptohet se 68 nuk i janë bindur ligjit për ta deklaruar pasurinë dhe origjinën e sajë. Këta zyrtarë i takojnë një liste të gjërë institucionesh, nga ato qendrore deri tek ato të nivelit lokal. Në këtë përbërje ka zyrtarë prokurimi, gjyqtarë, drejtor drejtorishë komunale etj³. AKK e ka konfirmuar se rastet në fjalë janë proceduar në gjykatë, dhe se janë në pritje të konfirmimit të ndëshkimeve për personat e lartpërmendur, të ngarkuar për kundërvajtje⁴.

Në bazë të ligjit, deklarimi bëhet në disa raste dhe nuk përbën vetëm atë vjetor. Kjo do ti mundësonte AKK-së të përcaktonte nëse statusi ekonomik i zyrtarit ka ndryshuar në atë masë sa edhe të hidhen dyshime për mundësi keqpërdorimi⁵. AKK pretendon se fuqia e kësaj organizate qëndron pikërisht në faktin se ka mandat për të kërkuar kurdo që e sheh të nevojshme një ri-deklarim të pasurisë nga cilido zyrtar që agjencia e sheh të nevojshme. Megjithate, nuk ka ndonjë të dhënë që AKK ta ketë ushtruar këtë mjet kontrolli deri më tani.

Agjencia Kundëër Korrupsionit pohon se kanë marrë informacione për deklarim jo të plotë të aseteve nga zyrtarë të caktuar, por nuk ka mundur të japë ndonjë të dhënë në lidhje me zyrtarët të nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Kjo shihet të jetë edhe arsyeja e skepticizmit që shfaqet në opinion mbi efektet e mundshme pozitive të procesit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë. Megjithate ka raste kur agjencia e sheh të nevojshme që zyrtarët ta riplotësojnë formularin, por kjo vetëm për shkaqe procedurale (pra kur formulari nuk është plotësuar në linjë me instruksionet)⁶.

³ Është interesant fakti se ka një numër të madhë të stafit akademik dhe atij diplomatik, të cilët nuk i kanë plotësuar formularët. Lista e plotë e zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë mund të gjendet tek: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,4,240>.

⁴ Shih: Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, neni 16: 1. Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, që nuk janë vepra penale, zyrtari i lartë publik bën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë: 1.1. e gjobë treqind (300) deri një mijë (1000) Euro, dënohet për kundërvajtje zyrtari i lartë publik për mos deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë; 1.3. Mund të gjendet tek: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,43>.

⁵ Po aty: 1.4. me gjobë prej njëqindpesëdhjetë (150) deri në pesëqind (500) Euro dënohen për kundërvajtje zyrtarët e lartë publikë për mos deklarimin e pasurisë pas largimit nga funksioni;

⁶ Intervistë e autorit me Jetullah Aliun, Drejtor i Departamenteve në AKK.

V. MOSDEKLARIMI DHE MOSPUBLIKIMI I FORMULARËVE ME RASTIN E MARRJES DHE LËNIES SË POSTIT

Nuk ka formularë të publikuar për zyrtarët që e kanë lënë funksionin publik ose janë shkarkuar. Të paktën këto informacione nuk janë publikuar në faqen zyrtare të AKK-së. Zyrtarët e divizionit të parandalimit në AKK konfirmojnë se disa nga zyrtarët e emëruar rishtazi, i kanë plotësuar formularët, por e arsyetojnë mospublikimin e tyre me probleme teknike⁷. Sipas zyrtarëve të AKK-së, është angazhuar një kompani për mirëmbajtjen e faqes së agjencisë, e cila edhe fajësohet për mospublikimin e formularëve në kohën e paraparë me ligj. Megjithatë, Agjencia ka treguar gadishmëri për të na i prezantuar kopjet fizike të atyre formularëve që janë plotësuar deri më tash.

Në rastin konkret të qeverisë aktuale, janë ndërruar gjithsej 6 ministra dhe një dyzinë zyrtarësh të nivelit të lartë. Nuk ka asnjë dëshmi në faqen zyrtare të internetit që tregon se këta zyrtarë e kanë plotësuar formularin (për shkaqet e përmendura më lartë). Megjithatë, zyrtarët e agjencisë thonë se të larguarit nga postet në fjalë “lajmërohen kohë pas kohe” dhe i plotësojnë formularët e deklaramit pas largimit nga pozita që e kanë mbajtur.

Gjobat

Siç u tha më lartë, agjencia është e mandatuar me ligj që të përcjell në gjykatë të gjitha rastet që e kanë shkelur ligjin për deklaram. Në rastin konkret “Agjencia ka pranuar 6 Aktvendime nga gjykata kompetente Komunale për Kundërvajtje lidhur me kërkesat që i ka iniciuar ... për mos deklaram të rregullt vjetor të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik...”. Megjithatë agjencia konfirmon se “ka iniciuar procedurën kundërvajtëse në Gjykatat kompetente Komunale për Kundërvajtje për të gjithë zyrtarët e lartë publik që nuk kanë deklaruar pasurinë [...] dhe atë menjëherë pas publikimit të formularëve në veb-sajtin e Agjencisë qysh në fillim të muajt qershor, dhe gjykatat kanë filluar të sanksionojnë zyrtarët për mos deklaram të rregullt vjetor të pasurisë”⁸.

⁷ Shih: Ligji për deklaramin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, neni 7: 1. Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarohen me shkrim pasurinë ekzistuese të fituar, detyrimet, burimet dhe origjinën e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve. Në pajtim me këtë nen, zyrtarët e lartë publik bashkëngjisin deklaramin mbi gjendjen pasurore të anëtarëve të familjes.

2. Organi i punësimit është i detyruar që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor ta njoftoj Agjencinë për fillimin apo përfundimin e punës së zyrtarit të lartë publik.

⁸ Përgjigjet me shkrim që AKK I ka dhënë autorit.

VI. DEKLARIMI NË MËNYRË JO TË RREGULLT

Nëse do të kërkohej një radhë për të vendosur zyrtarët e lartë për deklaram të parregullt të pasurisë, atëherë Presidenti i Republikës do të ishte ai që do të vendosej në krye të listës.

Në një shikim të shpejtë të formularit që ai e ka plotësuar, vërehet një qasje shkel e shko, si në informacionin e ofruar, poashtu edhe mënyrën e plotësimit. I gjithë formulari është i plotësuar keq dhe shumë rubrika vetëm janë nënvizuar në mënyrë kaotike. Kjo tregon qartë se sa seriozisht e ka marrë zyra e presidentit qështjen e deklaramit të pasurisë dhe prejardhjen së saj⁹. Kjo më së paku përbën shkelje të procedurave administrative, e më së shumti përbën shkelje të Ligjit¹⁰.

Sidoqoftë, i njëjti fenomen shfaqet me pothuajse të gjithë formularët, ku personat zyrtarë e kanë plotësuar formularin vetëm në momentet e fundit të përcaktuar me ligj¹¹.

Mangësitë më të shpeshta gjatë plotësimit të formularëve nga Presidenti, Kryeministri, Ministrat, shumica e deputetëve, drejtorët e ndërmarrjeve publike dhe zyrtarëve tjerë, janë me sa vijon:

- Mospublikimi i të gjitha asetëve në posedim;
- Mosdeklarami i kohës së përfitimit të asetëve;
- Mosdeklarami i mënyrës së përfitimit;
- Mosdeklarami i shumës së pagës mujore/vjetore;
- Mosdeklarami i maturitetit të kredisë;
- Mosdeklarami i këstit mujor;

Këto janë mangësi të cilat e bëjnë një formular të papërdorshëm për qëllime vlerësimi të saktë apo eventualisht hetimi të vërtetësisë së tijë. AKK nuk do të mundet të kuptoj nëse, për shembull, një zyrtar e ka ndërtuar apo blerë një shtëpi me të ardhura nga posti që e mbanë, nga mëshitetja familjare, e cila deklarohet shpesh në formularë, apo nga dhurata të paligjshme në këmbim të favoreve zyrtare.

Të njëjtat të meta vërehen edhe në shumicën e formularëve të plotësuar nga anëtarët tjerë të presidencës, qeverisë dhe ndërmarrjeve publike. Kjo tregon mungesën e seriozitetit me të cilin i janë qasur zyrtarët e lartë publik ligjit në fjalë. Shembull konkret mund të merret edhe formulari i Shefit Ekzekutiv të PTK Sh.A., z. Shyqri Haxha i cili në formularin e plotësuar nuk ka ven-

⁹ Për të parë formularin, shko tek: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1008,2860>. Aty vërehen një numër shkeljesh të cilat janë të sanksionuara me ligj, por që edhe formulari i specifikon qartësisht siç janë: të ardhurat e anëtarëve të familjes, të ardhurat nga paga e posteve publike që i ushtron zyrtari dhe të hyrat nga anëtarët tjerë në familje.

¹⁰ Shih: Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, neni 4.

¹¹ Shih datat e dorëzimit në fund të formularëve. Mund t'i gjeni tek: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,115>.

dosur as një vlerë monetare si për pasurinë as edhe për pagat që mer. Ai poashtu nuk ka deklaruar as edhe gjendjen e tij financiare perderisa nuk ka deklaruar të ket ndonjë astet ne vlerë monetare, si depozitë apo kesh¹². Bardhyl Sejdiu, drejtor i shërbimeve mbështetëse ka deklaruar një depozitë në monedhë në një bankë, një kredi të vogël dhe faktin se është pronar i 50% të aksionëve të një ndërmarrje të vogël poashtu.

Një rast specifik është edhe ai i deputetit Et'hem Çeku. Ai e ka publikuar pasurinë e fituar nga biznesi familiar dhe pagat mujore në institucionet publike. Proceduralisht, formulari nuk është në rregull, pasi që deputeti i ka deklaruar asetet në kompani të ndryshme si pasuri të luajtshme. Ky është një lëshim që e kanë bërë shumë zyrtarë tjerë. Z. Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, ka deklaruar se i ka të depozituara në banka mbi 203 mijë Euro. Por ai nuk e ka marrë mundin ta tregojë edhe prejardhjen e këtyre mjetëve. Për fat të keq, ai nuk ka qenë në gjendje as të tregojë pagën e tij mujore, aktuale dhe në të kaluarën. Formulari i plotësuar nga ministri i financave është kampioni më përfaqësues i formulareve të plotësuar keq dhe në mënyrë të papërgjegjshme, të cilët nuk mund të përdoren për asgjë.

Një tjetër rast është edhe formulari i zv. Shefit ekzekutiv të Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit, z. Valdet Gjinovci. Në formularin e tij vërehet se ai është bashkëpronar i një kompanie private, por e ka deklaruar si pasuri të luajtshme. Ai poashtu nuk e ka deklaruar origjinën e pasurisë së paluajtshme dhe as të hyrat mujore/vjetore¹³.

Në lidhje me këto raste, të cilat edhe vet agjencia e pranon se formularët nuk janë plotësuar në mënyrë të rregullt reagimi është i vakët. Përshtypja më negative vije nga opozita, e cila nuk ka marrë mundin që të deklarohet as edhe për një rast të vetëm të formulareve të plotësuar në mënyrë të parregullt nga zyrtarët qeveritarë. Pozicioni i tyre në raport me deklarimi ka qenë indiferent. Mbase atyre u mungojnë argumentet, ngase as formularët e tyre nuk janë të plotësuar në mënyrë të rregullt.

Përgjigja zyrtare ka qenë se "Agjencia në vazhdimësi është duke i kontrolluar formularët për deklarim të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik të cilët e kanë deklaruar pasurinë, [...] ndërsa për vitin 2010 do të pasqyrohen në vitin në vijim, pasi gjate gjithë vitit vazhdon procedura e kontrolimit"¹⁴.

Kreditë që kanë marrë zyrtarët janë një tregim me vehte, dhe formularët nuk e qartësojnë pak ose aspak këtë procedurë. Formulari të cilin e ka plotësuar Kryeministri për shembull, ka disa të meta në këtë drejtim, ku ndër të tjera janë edhe: mungesa e qartësisë në prejardhje të aseteve, fakti se kredia e marrë nuk plotëson kushtet e caktuara nga bankat në tregun financiar në Kosovë, si dhe mosdeklarimi i normës së interesit.¹⁵

¹² Shih: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1028,3001>

¹³ Shih formularin: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,985,2311>.

¹⁴ Përgjigjet me shkrim që AKK I ka dhënë autorit.

¹⁵ Bankat normalisht ofrojnë kredi me afat maturimi që i mundëson debitorit t'i shlyej këstet mujore me më së shumti një të tretën e pagës mujore.

E fundit meriton vëmendje, pasi që kamatat që aplikojnë bankat për zyrtarë të lartë mund të përbëjë edhe konflikt interesi*¹⁶. Arsye e fortë për këtë është se fenomeni i kredimarrjes vërehet tek shumica e zyrtarëve që e kanë deklaruar pasurinë. Në raportet që ka publikuar Instituti GAP (Bankometri), në tabelat të cilat bëjnë krahasimet e ofertave për kreditim nga bankat komerciale në Kosovë, mund të analizohet edhe mundësia që zyrtarët e lartë kanë për t'u kualifikuar për kredi të cilat kanë deklaruar se i kanë marrë¹⁷. Si konkluzion, formulari i deklarimit të pasurisë, në mes tjerash të metë e ka edhe mos adresimin e normës së interesit të cilën e ka aplikuar banka për zyrtarin.

VII. DEKLARIMET E RREGULLTA

Kryetari i komunës së Prishtinës Isa Mustafa, i prinë listës së deklaruesve të rregullt. Ai e ka plotësuar formularin në linjë të plotë me ligjin, duke i deklaruar asetet, borxhet, depozitat, si dhe aksionet që i posedon nëpër kompani të ndryshme. Megjithatë, qështja e vërtetimit nëse formulari përmban të dhëna të sakta prap mbetet në dorë të AKK-së¹⁸. Fehmi Mujota është një tjetër rast i cili i ka kushtuar kujdes plotësimit të formularit. Edhe pse në formular nuk figuron ndonjë pasuri e paluajtshme për banim, kjo mbetet të vërtetohet. Megjithatë deputeti ka qenë në gjendje të deklarojë qartë pasurinë, prejardhjen e sajë si dhe detyrimet financiare ndaj personave fizik dhe juridik¹⁹. Formulari i plotësuar nga Edita Tahiri përmban informacione të vendosura qartë, ndërsa është evidentuar saktë edhe prejardhja e pasurisë dhe detyrimet financiare ndaj personave juridik dhe fizik²⁰. Normalisht se ka edhe raste të tjera për t'i cilësuar si formularë të plotësuar në mënyrë të rregullt, mirëpo qëllimi se përse janë cekur pikërisht këta formularë është mundësia për të marrë shembuj të cilët mund të përdoren si pikë referimi. Thë gjitha këto raste mund të merren si shembuj ku zyrtarët i kanë kushtuar kohë dhe qasje seriozë plotësimit të formularit në fjalë.

¹⁶ Bankat mbase mund t'u ofrojnë vendim-marrësve kredi me kamata të buta në këmbim të politikave financiare në favor të bankave. Kujto se norma e interesit e aplikuar në Kosovë është më e larta në Europë.

*Në rastin konkret, Kryeministri ka marrë një kredi prej EUR100 000, me afat maturimi prej 120 muaj. Me një kamatë mesatare prej 8% atij do ti duhej të paguante mbi EUR 1100 nga paga e tij mujore prej dikund neto EUR 1500. Shiko formularin tek: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,981,2289>.

¹⁷ Për më tepër në këtë qështje, mund të shkarkoni tabelat krahasuese të GAP. Aty do të gjeni ofertat dhe kushtet që aplikojnë bankat për të gjitha format e kreditimit. Vëmendja duhet të fokusohet tek kreditë për shtëpi, pasi që shumica e zyrtarëve kanë deklaruar se kanë marrë një të tillë. Tabeliat mund ti gjeni tek: <http://www.gapinstitute.org/?cid=1,34>

¹⁸ Shih: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1130,2976>. Në pjesën më të madhe të formularit vërehet qartë qasja racionale dhe transparente në deklarim. Gjëja e vetme që do të duhej ti mbetej AKK-së në këtë rast është konfirmimi i validitetit të të dhënave.

¹⁹ Shih formularin: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1010,2761>

²⁰ Shih formularin: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1010,2783>.

VIII. PAMBULUESHMËRIA E ASETEVE TË PËRFITUARA ME PAGËN

Është për tu diskutuar fakti nëse shumica e zyrtarëve të lartë e kanë fituar pasurinë e tyre me pagat që ata marrin nga postet publike. Një numër i madh i tyre gjithnjë llogarisin edhe në mbështetje familjare. Në të gjithë formularët e analizuar, shihet se personat e deklarojnë të paktën një pasuri si të trashëguar. Kjo e bën të vështirë analizimin e pasurisë dhe formën me të cilën zyrtarët e kanë përfituar atë.

Mosdeklarimi i Prejardhjes

Prejardhja e pasurisë është një faktor për të cilin lirisht mund të themi se nuk është ndriquar me këta formularë. Si pasojë e kësaj, mbase mund të pritet që formularët e plotësuar tani, të sërbejnë si bazë për të analizuar asetet dhe dhuratat e zyrtarëve të lartë të përfituar gjatë periudhës sa kanë ushtruar detyrën e zyrtarit në deklaratimet për vitet e ardhshme. Por qështja mbetet se si do të mund të bëhet verifikimi i asetëve për zyrtarët aktual, ku procedura e verifikimit të asetëve dhe mënyrës së përfitimit të tyre mbetet jofunksionale, kryesisht për shkak të mungesës së integritetit të institucionit të AKK-së.

E gjithë qështja e pamundësisë së verifikimit të prejardhjes, sipas të gjitha gjasave vie edhe si pasojë e një historie të gjatë që e ka shkruar ekonomia informale dhe e kaluara komuniste dhe apartheidi që është ushtruar në Kosovë. Lufta edhe më tej i ka përkeqësuar gjërat, përderisa dy fonde të mëdha – “Tre Përqindëshi” dhe “Fondi Vendlindja Thërret” – janë menagjuar në mënyrë poashtu informale dhe pa ndonjë llogaridhënie të qartë publikut. Nëse duhet që AKK të ndërmarrë ndonjë iniciativë dhe të gërmojë në arkivat e këtyre fondeve (nëse ka mbetur ndonjë) apo jo, është qështje tejet politike dhe nuk ka të ngjarë që të ndodhë. Megjithatë, duhet të bëhet e qartë se është pikërisht koha e luftës në Kosovë ku ka filluar kontakti i elitës aktuale politike me buxhetin publik, rrjedhimisht me mundësinë e keqpërdorimit të tij.

Korrupsioni në institucione është edhe një qështje që do të mund të ishte ndriquar me rastin e deklarimit të prejardhjes së asetëve. Nëse ligji për deklarimin e pasurisë dhe AKK dhe prokuroria, si institucione implementuese do të kishin imponuar mekanizma të zbardhjes së prejardhjes së asetëve, atëherë lufta kundër korrupsionit do të kishte edhe një instrument të fuqishëm për evidentimin e rasteve korruptive.

Me ligjin për deklarimin e pasurisë, AKK është e autorizuar që të kontaktoj çdo institucion financiar, persona juridik apo privat për të vërtetuar korrektësinë e të dhënave të deklaruara në formularin e plotësuar nga zyrtari²¹. Në këtë rast kërkohet vetëm vullnet politik për të mos ndikuar në punën e AKK-së dhe vendosmëri e këtyre të fundit për të ushtruar në

²¹ Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, neni 15.

mënyrë strikte autoritetin e dhënë me ligj që të hetohet mbi këto fonde (gjë që nuk ka ndodhur deri më tash).

Megjithatë, zyrtarët e agjencisë konfirmojnë se ka raste që këtij institucioni t'i kenë shkuar informacione nga qytetarë, të cilët i kanë parë formularët e zyrtarëve dhe kan vërejtur se ata nuk i kanë publikuar në tërësi asetet e tyre. Por qështja mabaroon këtu, sepse ka pak të ngjarë që zyrtarët e AKK-së të iniciojnë procedura korrektuese apo ndëshkimore për shkak të (siç arsyetohen ata) mungesës së stafit dhe të bazës ligjore.

Është e kuptueshme se agjencia ka një infrastrukturë shumë të limituar për të qenë në gjendje të hulumtoj mbi prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve. E përbërë nga një grup prej gjithsej 4 vetash, divizioni i deklarimit nuk i ka as mundësitë e evidentimit të të dhënave, lëre më të hulumtimit nëse ka ndonjë pasuri e cila mund të ketë histori të papastër²². Këta katër zyrtarë e bëjnë kontrollin e formularëve në lidhje me saktësitë procedurale, skanimin e dokumenteve për publikim në faqen zyrtare si dhe protokollimin. Kjo procedurë natyrisht se merr kohë, dhe kërkohet një numër disa her më i madh dhe i kualifikuar i stafit për t'u angazhuar në zbatimin e ligjit në fjalë. Agjencia pohon se ia ka bërë të qartë kuvendit një sfidë të tillë por nuk deklaroon nëse mbështetja financiare dhe ngritja e kapaciteteve të agjencisë do të ndodhë në ndërkohë²³.

IX. DY PROBLEMET THEMELORE

Agjencia Kundër Korrupsionit vazhdimisht ka deklaruar se janë pikërisht raportet dhe të dhënat e ofruara nga kjo agjenci që iu kanë paraprirë rezultateve konkrete të kohëve të fundit në luftën kundër korrupsionit. Megjithate, për sa i përket deklarimit të pasurisë së zyrtarëve, agjencia e ka të pamundur që të arrij rezultate konkrete dhe të matshme në shifra, ashtu siç synon ligji për deklarimin e pasurisë. Kjo ndodhë për dy arsye.

Stafi

E para, agjencia nuk ka resurse të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për të evidentuar, analizuar dhe hetuar të gjithë materialin e ufruar nga zyrtarët e lartë. Zyrtarët e AKK-së shpresojnë që me rritjen e buxhetit të agjencisë, ata do të mund të angazhojnë staf shtesë në vitin në vijim. Megjithatë, stafit të ri do ti duhen trajnime dhe nuk pritët që të ketë ndonjë rezultat konkret përsa i përket shqyrtimit të formularëve të publikuar së fundmi.

²² AKK ka një staf prej 35 vetash në total.

²³ Intervistë e autorit me Jetullah Aliun, Drejtor I Departamenteve në AKK. 26. 07. 2010.

Legjislacioni i mangët

Qështja e dytë ka të bëjë me legjislacionin në fuqi i cili ka vetëm karakter *preventiv* por jo edhe *represiv*. Argumenti se qështja në fjalë rregullohet përmes kodit penal nuk qëndron. Kodi penal - respektivisht neni 307 i tij - nuk e sanksionon qëshjen e deklaramit të rremë në përgjithësi por vetëm një pjesë të përcaktuar qartë me këtë kod²⁴. Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, poashtu nuk ka asnjë dispozitë që e sanksionon deklaramin e rrejshëm²⁵. Ky është edhe pozicioni zyrtar i AKK-së, ku qartësohet se deklarami i rrejshëm nuk kualifikohet si vepër penale. Pra, në qoftë se një zyrtar i lartë, gjatë plotësimit të formularit, nuk i ka përshkruar të gjitha asetet që posedon, dhe kjo vërtetohet në ndërkohë nga AKK, ai nuk do të mund të ndiqet penalisht²⁶. Kur analizohen këto qështje që kanë të bëjnë me deklaramin, por më së shumti me indentifikimin e prejardhjes, atëherë nuk mund të arsyetohet nxjerrja e ligjit për deklaramin e aseteve.

Pavarësisht këtyre qështjeve të ngritura nga AKK, nuk mund të thuhet se ky institucion nuk i ka mekanizmat e duhur për ta ushtruar funksionin e kontrollit të pasurisë. Kjo nuk do të thotë se ata duhet ta bëjnë këtë tek të gjithë zyrtarët, por në rastin konkret, zgjedhja e zyrtarëve me përgjegjësi më të madhe do të duhej të ishte prioritet. Fatkeqësisht janë pikërisht këta zyrtarë formularët e të cilëve nuk kontestohen, madje edhe kur vërehet qartë se ka shkelje flagrante si procedurale, e poashtu edhe në lidhje me integritetin e të dhënave.

²⁴ Shih: Kodi I Përkohshëm Penal i Kosovës, UNMIK/RREG/2003/25 Gazeta Zyrtare. 6 korrik, 2003. Neni 307: (1) Dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore, në rocedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore ep deklaratë të rreme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit. Mund të gjëndet tek:

<http://www.md-ks.org/?page=1,95>

²⁵ Shih: Ligji për deklaramin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik Nr. 03/L-151. Neni 16. Ky nen I përcakton qartë se këto dispozita u referohen veprave që nuk përbëjnë vepër penale: 1. Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, që nuk janë vepra penale, zyrtari i lartë publik bën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë...

²⁶ Intervistë e autorit me Jetullah Aliun, Drejtor I Departamenteve në AKK. 26. 07. 2010.

X. PËRFUNDIM

Gjasat që Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik të jetë i zbatueshëm dhe të prodhoj efekte në drejtimin e synuar janë shumë të vogla. Arsyeya më e madhe për këtë është se mungon integriteti institucional dhe ligjor. Legjislacioni aktual nuk i ka dispozitat sanksionuese që e bëjnë deklarinin e pasurisë dhe prejardhjen.

Përgjatë kësaj analize, është pasqyruar rasti i zyrtarëve të cilët nuk e kanë publikuar pasurinë e tyre dhe prejardhjen e sajë. Aty është vërejtur se janë gjithsej 68 zyrtarë, rastet e të cilëve janë dërguar në gjykatë për tu proceduar më tutje me gjoha administrative për mosrespektim të limitit kohor të përcaktuar me ligj për deklarim të aseteve. Është trajtuar qështja e problemeve teknike të cilat nuk kanë mundësuar që formularët e zyrtarëve të rinjë të publikohen në faqen zyrtare të AKK-së.

Deklarimi i rregullt është vërejtur në shumë pak raste dhe ato janë theksuar në këtë raport. Megjithatë, në shumicën e rasteve janë vërejtur shkelje flagrante të rregullave mbi poltësimin e këtyre formularëve. Zyrtarët nuk kanë arritur që të prezantojnë qartë asetet dhe prejardhjen e tyre me këta formularë. Në të shumtën e rasteve, ata nuk i kanë prezantuar një kategori apo një tjetër, gjë që i bën formularët gati totalisht të padobishëm.

Problemet më të mëdha që kanë të bëjnë me deklarinin e pasurisë së zyrtarëve janë identifikuar të jenë së pari ato të karakterit teknik, si mungesa e stafit dhe e resurseve tjera që do ti mundësonin AKK-së dhe prokurorisë zbatimin e ligjit. Dhe problemi tjetër ka të bëjë më bazën ligjore, përderisa legjislacioni në fuqi nuk vë sanksione dhe nuk e klasifikon si vepër penale deklarinin e rrejshëm, që në fakt përbën mashtrim.

Kur është promovuar ligji për deklarimin e pasurisë, zyrtarët publik kanë aluduar në atë se luftës kundër korrupsionit po i shtohet edhe një instrument i fuqishëm parandalues dhe ndëshkues. Megjithatë, ajo që është parë deri më tani tregon qartë se ky ligj as për së afërmi nuk e ofron atë mundësi. Kjo për vet faktin se, si i tillë ligji është hartuar me mangësi të shumta. Zyrtarët poashtu, as për së afërmi nuk i japin rëndësi procesit të deklarimit të pasurisë.

Si përfundim, nuk ka ndonjë indikacion që tregon se ky ligj do ti shërben dikujt për ta luftuar korrupsionin. Prandaj, i gjithë procesi i hartimit dhe implementimit deri më tani ka qenë një përpjekje për të krijuar një perceptim të rrejshëm, se ky ligj e zbulon të vërtetën mbi pasuritë e zyrtarëve. Kjo nuk ka ndodhur.

PERSONNEL:

Ismet KRYEZIU - *Executive Director*
Vjollca VOGËL - *Admin & Finance Manager*
Leonora CIKAJ - *Admin & Finance Assistant*
Arsim GJINOVCI - *IT & design*

PROGRAM - CENTRAL GOVERNANCE:

Valmir ISMAILI - *Program Manager*
Driton SELMANAJ - *Program Assistant*
Isuf ZEJNA - *Monitor*
Besnik RAMADANAJ - *Monitor*
Liridon SELMANI - *Monitor*

PROGRAM - LOCAL GOVERNANCE:

Naim CAHANAJ - *Coordinator*
Ramadan KLISURICA - *Coordinator*

PROGRAM - TRANSPARENCY AND ANTICORRUPTION

Merita MUSTAFA - *Program Manager*
Esat MAZREKU - *Coordinator*

This publication was made possible through support provided by U.S. Agency for International Development Mission in Kosovo under the terms of Award Number: 167-A-00-00108-00-NAP05-2009.

The opinions expressed here in are those of the author and do not necessarily reflect the views of the U.S. Agency for International Development (USAID).

Ky publikim është realizuar me mbështetje të siguruar nga Agjencioni i SHBA-s për Misionin Ndërkombëtar për Zhvillim në Kosovë nën kushtet e Numrit të grantit: 167-A-00-00108-00-NAP05-2009.

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorit dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Table of Contents

Introduction 20

Methodology 21

Findings..... 21

Evaluation of cases of those who didn't disclose their assets..... 22

Non-disclosure and non-publication of forms while taking and
resigning from a post..... 23

Fines..... 23

Irregular Disclosure..... 24

Deficiencies..... 24

Loans..... 25

Regular disclosures..... 26

Non-coverage of assets by funds acquired through salary..... 27

Non-disclosure of Origin 27

Two essential issues..... 28

Staff..... 28

Deficient legislation..... 29

Conclusion..... 30

